



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 182

Tiranë – E premte, 13 tetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10630, datë 9.10.2017	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 9151
Dekret i Presidentit nr. 10631, datë 9.10.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 9151
Dekret i Presidentit nr. 10632, datë 9.10.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 9151
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 21, datë 2.10.2017	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 15, datë 19.5.2017, “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2017- 2018”, të ndryshuar..... 9152
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 467, datë 2.10.2017	Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë..... 9153

**DEKRET**

Nr. 10630, datë 9.10.2017

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Muharrem Besnik Huçi
2. Mimoza Sali Kallja
3. Oltenca Lavdrim Osmani
4. Mariana Vangjel Windisch (Selenica)
5. Parenz Zamir Nezaç
6. Anila Pajtim Kalari
7. Anuar Bajram Kalari
8. Ajan Bajram Kalari
9. Najada Ilija Abeshi (Dande)
10. Andi Arben Zaganjori
11. Fjorela Aleksandër Çuko
12. Emiljana Branko Popaj
13. Diana Zenelabedin Shpati
14. Liljana Sabri Berisha (Hoxha)
15. Endre Gëzim Zeqja
16. Joelle Artan Baho
17. Aisi Ram Bella (Demushi)
18. Melvi Mexhit Disha
19. Frida Xhemal Brecht (Bramo)
20. Bardhyl Bajram Fetishi
21. Elvira Imer Rreshka (Vejseli)
22. Sara Besnik Rreshka
23. Ema Bujar Tahira
24. Ervis Astrit Velika
25. Etleva Vladimir Loshi (Prifti)
26. Stiv Gjergji Sterjo

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET

Nr. 10631, datë 9.10.2017

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Jahir Ali Ahmeti
2. Lia Zhora Putkaradze
3. Kamber Niyazi Gülabi
4. Xhelal Fadil Çollaku
5. Dorina Halim Boni (Qarkaxhija)
6. Tea Zviad Ivanauri
7. Avdullah Salih Hajdaraj
8. Rushe Smajl Kabashi (Shala)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET

Nr. 10632, datë 9.10.2017

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Rafije Tosun Mema (Murati)
2. Asmaa Amr Aly Wafi
3. Shpend Shemsi Lushaku



4. Elsa Enver Mara
(Dhjamandi/Diamandi /Diamanti)
5. Avdullah Brahim Neziri
6. Elhame Haki Koçi (Memeti)
7. Prek Pashk Radi
8. Afërdita Ukë Gjoni (Musollaj)
9. Anita Halim Kollçaku
10. Fadil Hakik Alija
11. Naile Rushit Bushi (Rrustemi)
12. Rrahman Rifat Qevani
13. Fidaije Haki Qevani (Zena)
14. Asmae Tahami Nekkach
15. Atije Imer Xhemaili (Ramani)
16. Ramy Fawzy Attalla Moawed
17. Adem Beqir Hadergjonaj
18. Ulrich Salomon Walter Felix Landolt
19. Sylvia Roger Spahija (Marçais)
20. Arbër Xhevat Domi
21. Blerta Murat Dervishi (Blakaj)
22. Dea Shaban Buza
23. Betim Fatmir Hoxhaj
24. Zijavere Asllan Ahmeti (Shemsija)
25. Monica Mihai Carp
26. Đusta Nikola Stanaj (Camaj)
27. Arta Zef Pashuku (Dedaj)
28. Ruzhdi Muharrem Bytyqi
29. Vera Viktor Danilina
30. Talat Muamer Gjinolli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM

Nr. 21, datë 2.10.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 15, DATË 19.5.2017, “PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË VITIN AKADEMIK 2017-2018”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Pika 2 e gremës “C”, e kreut III të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“2. Periudha 1 tetor deri 14 tetor është e ndarë në 7 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në njërin apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

Kur ai është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë. Për programet e studimit të ofruara nga universitetet private, të cilat nuk parashikojnë kritere shtesë, nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe.

Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 7 fazave 48-orëshe, MASR-ja dhe QSHA-ja do të publikojnë një udhëzues teknik në faqet përkatëse zyrtare: www.arsimi.gov.al dhe www.qsha.gov.al”.

2. Pika 4 e gremës “C”, e kreut III të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“4. Në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj mund të regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Këto faza vijnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën 14 tetor 2017. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara të cilat nuk ka aplikantë në pritje, do të rikthehen në garë aplikantët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të



tjera studimi. Rikthimi në garë kryhet sipas listës së renditjes të aplikantëve për raundin e dytë.”

3. Pika 14 e kreut VI/1 të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“14. Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore nga data 10 tetor 2017 deri në datën 14 tetor 2017, sipas dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës 24 tetor 2017.”

4. Pika 15 e kreut VI/1, të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“15. IAL-të, brenda datës 27 tetor, 2017 dërgojnë në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format *Excel*, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin e tyre.”

5. Pika 1 e kreut VI/3, të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“1. Të gjithë kandidatët shtetas të huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë (IAL), nga data 16-19 gusht 2017, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL.”

6. Germa “b” e pikës 14, e kreut VI/3, të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“b) Njohja e dokumentacionit të kandidatëve fitues, të pajisur me diploma të huaja, në programet e përbashkëta të studimit, kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA-ja kryen regjistrimin e tyre përfundimtar me statusin e

studentit dhe brenda datës 26 janar 2018 ia komunikon IAL-së.”

7. Germa “f” e pikës 14, e kreut VI/3, të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“f) IAL-të, brenda datës 27 tetor, 2017 dërgojnë në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format *Excel*, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin e tyre.”

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, DAR/ZA-të, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

URDHËR
Nr. 467, datë 2.10.2017

**PËR DELEGIMIN DHE DISA RREGULLA
TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË
MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE
RINISË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 28, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në proceset gjyqësore kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kur thirret si palë në gjykim, në proceset gjyqësore, në të cilat institucioni i varësisë ka lidhje me objektin e padisë, lëshohen në emër të personit që do të përfaqësojë



ministrinë, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, sipas vendit ku është ngritur kërkesëpadia.

3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor bëhet nga juristë të Drejtorisë së Shërbimeve Juridike dhe specialistë të fushës për të cilën është ngritur kërkesëpadia, nëpërmjet autorizimit të lëshuar.

5. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në proceset gjyqësore, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesve të autorizuar të kryejnë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.

6. Përfaqësuesit e caktuar të ndjekin me korrektësi seancat gjyqësore, për sa i takon pjesëmarrjes së tyre, e veçanërisht kontributit provues, paraqitjes së kërkesave, prapësimeve, pretendimeve, ankimeve, rekurseve, si dhe dokumenteve të tjera, që do të ndihmonin mbrojtjen e përpiktë të interesave të institucionit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

7. Në përfundim të proceseve gjyqësore, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda një afati 5-ditor nga shpallja/njoftimi i vendimit, të paraqitet

informacion i detajuar, i shoqëruar me vendimet përkatëse në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

8. Ngarkohen të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, qendrore dhe territoriale, të caktojnë një person përgjegjës që do të jetë pikë kontakti për të shkëmbyer çdo njoftim për ecurinë dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore, me Drejtorinë e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

9. Ngarkohet Sektori i Redaktimit Gjuhësor, Shërbimeve dhe Arkiv/Protokollit për vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme në cilësinë e provave materiale për proceset gjyqësore.

10. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Shërbimeve Juridike, Sektori i Redaktimit Gjuhësor, Shërbimeve dhe Arkiv/Protokollit, institucionet e varësisë së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla



Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____ / _____ / 2017

AUTORIZIM
PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN ADMINISTRATIVE/ CIVILE ME PALË:

Padi tës:

E paditur:

Objekti:

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe të urdhrin të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 467, datë 2.10.2017, “Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”,

VENDOSA:

Autorizimin e z./znj. , me detyrë, për të përfaqësuar Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin/rekursin në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative/civile me objektin e sipërcituar, deri në shpalljen e vendimit në (gjykatën kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjes përkatëse).

PLARENT NDRECA

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë